

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Mirëqenies Sociale, Korrik 2023


24.08.2023

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin korrik 2023.

### Bie numri i përfituesve nga skema e pensioneve invalidore në korrik 2023, krahasuar me korrik 2022

Në muajin korrik 2023, nga skema e ndihmës sociale kanë përfituar 20 937 familje me gjithsej 82 621 anëtarë, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak që ishte 25 088 familje me gjithsej 98 832 anëtarë, vërehet një rënie e numrit të familjeve përfituese nga kjo skemë për 4 151 ose 16,5%.

#### Numri i përfituesve nga skema e ndihmës sociale



## Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin korrik 2023, krahasuar me muajin korrik 2022, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-20,6%); skema për pensionet e Trepçës (-18,2%); skema për pensionet familjare (-8,9%); skema e pensioneve kontribut-paguese të moshës (-3,1%); skema e pensioneve bazike të moshës (-2,0%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,7%); skema për veteranët e luftës (-0.2%).

## Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin korrik 2023, krahasuar me muajin korrik 2022 kishte rritje të numrit të përfituesve nga: Skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (14,8%); skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës (10,6%); skema për pensionet e personave paraplegjik dhe tetraplegjik (7,6%); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (5,3%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (4,9%); skema e kompensimeve për personat e verbër (4,3%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,4%).

## Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale

Përfituesit e pensioneve dhe skemave tjera sociale	Muaji/Viti	
	07.2022	07.2023
Pensionet bazike të moshës	151 812	148 802
Pensionet kontributpaguese të moshës	50 303	48 758
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara	18 585	19 562
Pensionet e Trepçës	1 839	1 505
Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës	670	741
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	1 259	1 302
Skema e të verbërve	1 782	1 858
Pensionet Familjare	3 335	3 039
Pensionet e Invalidëve të punës	63	50
Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike	2 543	2 737
Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99	12 661	13 285
Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	13 170	12 950
Veteranët	36 750	36 821
Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	2 811	3 228

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin korrik 2023, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/SocialWelfare>